

V E N D I M
Nr. 648, datë 13.12.2002

**PËR NDALIMIN E PËRKOHSHËM TË PRERJES SË LËNDËVE DRUSORE, ME
PËRJASHTIM TË ASAJ QË PËRDORET PËR DRU ZJARRI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 21 e 22 të ligjit nr. 7623, datë 13.10.1992 "Për pyjet dhe policinë e shërbimit pyjor", me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Ndalimin e prerjes së lëndëve drusore, për një periudhë të pacaktuar kohe, me përjashtim të asaj që rezulton nga trajtimi i pyjeve, me punime të detyrueshme përmirësimi, dhe i parcelave për prodhimin e druve të zjarrit.

2. Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit dhe Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit të nxjerrin udhëzimin e përbashkët për përcaktimin e procedurave të furnizimit të banorëve të zonave rurale me dru zjarri, lëndë ndërtimi dhe gjithë për blegtorinë, për nevojat vetjake.

3. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit, Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Pyjeve dhe e Kullotave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano